



Hekurudhat e Kosovës

RAPORT VJETOR 2016

Vendimi: Nr. 2/23

Bordi i Drejtorëve i HK “Trainkos” Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2015 në mbledhjen Nr. 8 të mbajtur më datë 10.03.2016

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	Gelor Shala Kryeshef Ekzekutiv	Sadik Kryeziu Kryesuesi i BD
Nënshkrimi:		
Data:	15.02.2016	10.03.2016



trankos

HEKURUDHAT E KOSOVËS

RAPORT VJETOR

2015



PËRMBAJTJA

I.	Hyrje	3
II.	Raport i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve	4
II. 1.	Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	4
II. 2.	Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden	7
II. 3.	Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv	8
II. 4.	Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A	9
III.	Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv	11
III. 1.	Ngjarjet kryesore të vitit	13
III. 2.	Pasqyra e performancës operative	14
III. 3.	Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet	21
III. 4.	Projektet kapitale	27
III. 5.	Perspektiva për vitin e ardhshëm	30
III. 6.	Rreziqet e të ardhmes së korporatës	31
IV.	Struktura organizative e Trainkos Sh.A	32
IV. 1.	Kontestet gjyqësore në periudhën janar - dhjetor 2015	34
IV. 2.	Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2015	34
IV. 3.	Transaksionet e realizuara	36
V.	Përfundim	37
I.	Aneks Raporti	
	Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet	
	Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2015	
	Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve	

I. HYRJE

Gjatë gjithë vitit 2015, kompania kishte një ecuri progresive drejt realizimit të planit operativ dhe financiar. Megjithatë ndërmarrja edhe gjatë këtij viti u ballafaqua me sfida të shumta e të ndryshme. Falë angazhimit të palodhshëm të tërë ekipit të HK-Trainkos Sh.A është arritur që ndërmarrja ta ruaj likuiditetin e saj.

Në kuadër të këtij raporti do të përfshihen aktivitetet dhe ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarrjes të vitit 2015. Raporti është ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe udhëzimeve të Aksionarit si dhe përmban edhe disa pjesë tjera të rëndësishme që e pasurojnë edhe më shumë këtë raport.

Në fillim të raportit është prezantuar fjala e kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, ku është theksuar performanca e kompanisë bashkë me disa prej aktiviteteve të saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë, politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj si dhe të dhënat tjera për strukturën dhe angazhimet e Bordit.

Në vazhdim raporti vijohet nga raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Në këtë pjesë raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore e skema tjera me sqarime të nevojshme.

Raporti Vjetor 2015 i HK-Trainkos Sh. A. ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të Aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, raport vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2015 dhe raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

II. RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Nga mesi i muajit shtator 2015 është emëruar Bordi i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh. A. Që nga kjo periudhë Bordi është angazhuar me përkushtim të lartë që ndërmarrja të ketë kontinuitet të punëve në arritjen e rezultateve në raport me objektivat e planifikuara.

Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësi ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve. Po ashtu edhe angazhimi i stafit menaxhues si dhe drejtorëve të Bordit që kanë vepruar deri në emërimin e Bordit aktual është për t'u vlerësuar.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2015.

II. 1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes kanë qenë në realizimin e objektiveve të planifikuara për vitin 2015 si dhe angazhimi në tejkalimin e pengesave dhe vështirësive tjera.

Një ndër sfidat me të cilat u ballafaquam qysh në fillim të punës sonë, ishte mungesa e mjeteve për të mbuluar shpenzimet në transportin e udhëtarëve, sfidë e cila është duke vazhduar edhe tani. Përderisa mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është definuar qartë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, kjo çështje ende nuk ka marr zgjidhjen e duhur nga institucionet përkatëse. Çështja e mbulimit të shpenzimeve të transportit të udhëtarëve është njëri prej problemeve që e ka përcjell ndërmarrjen qysh nga ndarja e Hekurudhave të Kosovës dhe si e tillë ende nuk është trajtuar sipas kërkesave ligjore. Mjetet e ndara nga Buxheti i Kosovës për këtë qëllim për çdo vit radhazi kanë ardhur duke u zvogëluar, po ashtu edhe rëniet në transportin e udhëtarëve kohëve të fundit kanë qenë shumë të theksuara të cilat kanë bërë që ndërmarrja të jetë në një situatë tejet të vështirë. Kjo çështje

do të jetë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2015**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2015 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Për shkak të gjendjes në ndërmarrje, mosmbulimit të shpenzimeve në transportin e udhëtarëve dhe për shkak të rënies së transportit të mallrave ndërmarrja ka bërë rishikimin e Planit të Biznesit për vitin 2015.

Në saje të angazhimit të përbashkët të Bordit dhe të stafit të kompanisë, kemi arritur që objektivat e përcaktuara t'i përmbushim në pjesën më të madh të tyre.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

Bashkëpunimi me institucionet vendore e ndërkombëtare ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Në këtë drejtim ka pasur disa avancime në ndërtimin e një bashkëpunimi shumë domethënës. Projekti i fituar nga qeveria holandeze për trajnimin e stafit ekzekutiv (makinistë, ndihmës makinistë/udhëheqës treni, frenues manovrues si dhe për stafin e mirëmbajtjes) ka filluar të realizohet gjatë vitit 2015, i cili do të vazhdojë edhe në vitin 2016 me mundësi vazhdimi edhe për dy vitet e ardhshme dhe ka një vlerë prej 548,444.80 €.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2015 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat jo të kënaqshëm operativ e financiar. Përkundër angazhimit maksimal të menaxhmentit të kompanisë kemi pësuar rënie në transportin e mallrave si rezultat i ndikimit të faktorëve të jashtëm. Po ashtu edhe në këtë vit realizimi financiar në transportin e udhëtarëve ende ka mbetur i paarrtshëm për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Qeveris së Republikës së Kosovës ashtu siç është paraparë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për 8.6 % neto tonë mallra të transportuara më pak se sa planifikimi, apo për 13.4 % më pak se realizimi gjatë vitit 2014.

Performanca financiare nga transporti i mallrave është për 17 % më pak se sa planifikimi vjetor 2015, ndërsa krahasuar me vitin paraprak është më pak për 30 %.

- **Transporti i Udhëtarëve**

Performanca operative në numrin e udhëtarëve është për - 23.85 % më pak në krahasim me vitin paraprak si dhe për - 21.8 % më pak se sa planifikimi për vitin 2015.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave, përkatësisht të të hyrat nga kjo kategori kanë qenë - 36,466.33 € krahasuar me planifikimin 2015, ndërsa krahasuar me vitin 2014 të hyrat kanë qenë prej - 18.36 % më pak. Për shkak të mosrespektimit të Ligjit për Hekurudhat shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtareve ende mbeten të pambuluara.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre të cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2015 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse. Kjo gjendje do të vështirësohet edhe më shumë pasi që për vitin 2016 në Buxhetin e Kosovës nuk janë paraparë mjetet për investime në projekte kapitale të Trainkos Sh.A.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A

Po ashtu, sfida e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Gjatë vitit 2016, presim që të arrihet marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për mbulimin e shpenzimeve në Transportin e Udhëtarëve ashtu siç parashihet me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

Gjithashtu vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtiveve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante.

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për këtë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve apo formave tjera për investim, për këtë qëllim kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik.

Për të përcaktuar nevojat për investime, kompania është e angazhuar në hartimin e një plani afatmesëm për investime.

Përkundër sfidave me të cilat ballafaqohemi, vitin e ardhshëm presim arrijten e objektivave të parapara në planin e biznesit për vitin 2016 siç është rritja e transportit të mallrave vendor dhe ndërkombëtarë si dhe rritje në transportin e udhëtarëve.

II. 2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Përkundër ngecjeve dhe vështirësive që ka pasur në realizimin e projekteve në të kaluarën, gjatë vitit 2015 ndërmarrja ka zhvilluar procedurat për të gjitha projektet kapitale të planifikuara. Projektet janë në fazën finale të realizimit dhe së shpejti do t'i kemi në funksion.

Mjetet për projektet kapitale në shumën prej 1,091,859.00 € të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2015 janë shfrytëzuar në tërësi. Po ashtu ndërmarrja edhe me buxhetin e saj ka realizuar disa projekte të rëndësishme.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk kanë nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh që do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Ndërsa sa i përket shpërndarjes së **dividentës**, ndërmarrja nuk ka arritur atë nivel të realizimit (fitimit) për ta ndarë atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

II. 3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Duke pasur parasysh vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 06/49, të datës 16.09.2015, për emërimin e Bordit të HK-Trainkos Sh.A, të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë në këtë pjesë të raportit do të pasqyrohen edhe për Bordin e Drejtorëve që ka funksionuar deri më 16.09.2015.

Struktura e Bordit të Drejtorëve deri më datën 16.09.2015 ka qenë e përcaktuar në bazë të disa vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës: Vendimit për emërimin e Bordit të Përkohshëm të Bordit të Drejtorëve më nr. 04/24 të datës 20.07.2011; Vendimit nr. 27/53 të datës 21.12.2011 për vazhdimin e Bordit të Drejtorëve deri në përzgjedhjen e bordit të ri; si dhe në bazë të Vendimit të Ministrit të MZHE-së 01/1912, të datës 22.10.2014 për emërimin e z. Hestet Cakolli në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Kryesuesit pas dorëheqjes së Kryesuesit, i cili ka mbajtur këtë pozitë deri më 22.10.2014.

Bazuar në vendimet e theksuara më sipër dhe në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2015 janë mbajtur gjithsejtë 14 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, nëntë prej tyre janë mbajtur deri më datën 16.09.2015 dhe pesë mbledhje tjera janë mbajtur pas kësaj date.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen të dhënat e vendosura në tabela për strukturën e Bordit të Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të cilat kanë funksionuar gjatë vitit 2015.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë deri më datën 16.09.2015:

PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK TRAINKOS SH.A DERI MË 16.09.2015			
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Heset Cakolli	Kryesues	9
2	Labinot Halilaj	Anëtar	9
3	Shkumbin Hyseni	Anëtar	9
4	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	7
5	Afrim Kuleta	Sekretar	8

Sipas të dhënave në tabelën më sipër, Bordi i Drejtorëve që ka funksionuar deri më 16.09.2015, ka mbajtur gjithsej 9 mbledhje duke përfshirë edhe Mbledhjen e Përgjithshme me Aksionarin.

Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutivë pas datës 16.09.2015:

PËRBËRJA E BORDIT TË DREJTORËVE TË HK TRAINKOS SH.A PAS DATËS 16.09.2015			
Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
1	Sadik Kryeziu	Kryesues	5
2	Naim Gashi	Anëtar	4
3	Labinot Halilaj	Anëtar	5
4	Bujar Hasimi	Anëtar	5
5	Bastri Sallahu	Anëtar	5
6	Mustafa Mustafa	Anëtar	5
7	Gelor Shala	Kryeshef Ekzekutiv	4
8	Afrim Kuleta	Sekretar	5

Sipas të dhënave në tabelën më sipër, Bordi i Drejtorëve pas datës 16.09.2015, ka mbajtur gjithsej pesë mbledhje, njëra prej këtyre ka qenë mbledhje e jashtëzakonshme.

II. 4. KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË TRAINKOS SH.A

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari.

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim të dhënat për përbërjen e këtyre komiteteve, kohën e funksionimit si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2015.

Në pjesën në vijim prezantohen të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komiteteve të Bordit që kanë funksionuar deri më datën 16.09.2015 dhe të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe të komiteteve të bordit pas kësaj date:

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e Bordit që kanë funksionuar deri më datën 16.09.2015:

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 07.09.2011 – 16.09.2015	1 Labinot Halilaj	Kryesues	8
	2 Shkumbin Hyseni	Anëtar	8
KOMITETI PËR STAF DHE SHPËRBLIME 01.08.2014 – 16.09.2015	1 Shkumbin Hyseni	Kryesues	8
	2 Labinot Halilaj	Anëtar	8
KOMITETI PËR PROJEKTE KAPITALE 01.08.2014 – 17.03.2015	1 Heset Cakolli	Kryesues	2
	2 Shkumbin Hyseni	Anëtar	2
KOMITETI I FINANCAVE 01.08.2014 – 16.09.2015	1 Heset Cakolli	Kryesues	7
	2 Labinot Halilaj	Anëtar	7
KOMITETIT PËR POLITIKAT STRATEGJIKE 30.04.2015 – 16.09.2015	1 Shkumbin Hyseni	Kryesues	3
	2 Labinot Halilaj	Anëtar	3

Të dhënat për Komisionin e Auditimit dhe komitetet e bordit që kanë funksionuar pas datës 16.09.2015 janë prezantuar në vijim:

Vlen të theksohet në këtë rast se, duke u bazuar në rekomandimin e Komisionit Ndërmintor, angazhimi i drejtorëve të Bordit në këto komitete është pa kompensim.

Komiteti (koha e funksionimit)	Emri dhe Mbiemri	Pozita	Pjesëmarrja në mbledhje
KOMISIONI I AUDITIMIT 09.10.2015 - aktiv	1 Labinot Halilaj	Kryesues	3
	2 Naim Gashi	Anëtar	3
	3 Mustafa Mustafa	Anëtar	3
KOMITETI PËR STAF DHE SHPËRBLIME 30.10.2015	1 Sadik Kryeziu	Kryesues	2
	2 Labinot Halilaj	Anëtar	2
KOMITETI PËR PROJEKTE KAPITALE 30.10.2015 - aktiv	1 Naim Gashi	Kryesues	2
	2 Bastri Sallahu	Anëtar	2
KOMITETI I FINANCAVE 30.10.2015 - aktiv	1 Bujar Hasimi	Kryesues	1
	2 Mustafa Mustafa	Anëtar	1

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A
Sadik Kryeziu – Kryesues

III. FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Ndërmarrja HK-Trainkos Sh. A. arriti që edhe vitin 2015 ta përmbyll me sukses dhe rezultate të kënaqshme. Ky sukses në radhë të parë i atribuohet angazhimit maksimal të të gjithë strukturës organizative duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri tek pjesa e stafit operativ.

Përkundër rezultateve të arritura, viti 2015, karakterizohet edhe me disa sfida dhe probleme të reja e të vjetra. Mirëpo, përkundër këtyre vështirësive ndërmarrja ka pasur një stabilitet financiar falë kujdesit të treguar në raport me shpenzimet, rritjes së masave të kontrollit dhe përdorim racional të të gjitha resurseve. Këto janë veprimet kryesore që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në arritjen e një performance të mirë në vitin 2015.

Ngecjet më të theksuara kanë qenë në realizimin e objektivave nga të hyrat në transportin ndërkombëtarë si rezultat i krizës ekonomike në eurozonë e posaçërisht në Greqi ku dihet se transportin më të madh e kemi nga porti i Selanikut. Po ashtu, ngecje tjetër ka qenë edhe shkurtimi i të hyrave nga Marrëveshja për Obligimet e Shërbimeve të Përbashkëta – OSHP.

Puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë të rregulloreve të brendshme me legjislacionin në fuqi ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015, po ashtu është trajtuar edhe aspekti i përshtatshmërisë me direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullave ndërkombëtare të operimeve në transportin hekurudhor.

Sa i përket realizimit të detyrave dhe respektimit të afateve ligjore të raportimit, ndërmarrja ka arritur që dhe këto obligime t'i përmbush me sukses. Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron, siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurruese të tregut. Në të njëjtën kohë kemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Një prej sukseseve të veçura gjatë vitit 2015 është realizimi i projekteve kapitale, projekte të cilat së shpejti do t'i kemi në operime. Përkundër realizimit të këtyre projekteve, sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK-Trainkos Sh.A. mbetet padyshim investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë). Për shkak të gjendjes së mjeteve lëvizëse, vjetërsisë së tyre dhe amortizimit, kërkohen investime emergjente.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e

Kosovës - Trainkos Sh. A. Mjetet e ndara për projektet kapitale në vitin 2015 janë shfrytëzuar në disa projekte të rëndësishme, por megjithatë gjendja ende nuk është e kënaqshme sa i përket mjeteve lëvizëse. Kjo gjendje do të vështirësohet edhe më shumë pasi që për vitin 2016 në Buxhetin e Republikës së Kosovës nuk janë paraparë mjetet për investime në projekte kapitale të Trainkos Sh.A.

Fillimi i investimeve në modernizimin e rrjetit hekurudhor është shumë më rëndësi për zhvillimin hekurudhor, por nga kjo kërkohet që investimet të shtohen edhe në modernizimin e mjeteve lëvizëse të HK-Trainkos Sh.A.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë. Do të vendosim objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë

**Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala**

III. 1. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Aktivitet më me rëndësi të cilat na kanë shoqëruar gjatë vitit 2015 janë të paraqitura si në vijim:

Bashkëpunimi me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave të Kosovës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2015. Vlen të theksohet se ndër aktivitet më me rëndësi për këtë vit ka qenë certifikimi i makinistëve i paraprirë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës dhe rregulloret e brendshme të kompanisë. Këtij procesi i ka paraprirë edhe Licencimi i makinistëve i cili është finalizuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave.

Procesi i Licencimit të makinistëve ka ndodhur për herë të parë në Republikën e Kosovës, i cili ka qenë tërësisht në harmoni me direktivat e BE-së për licencim dhe certifikim.

Po ashtu, edhe këtë vit është arrit marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për Obligimet e Shërbimeve të Përbashkëta - OSHP, edhe pse nuk i mbulon gjithë trenat siç e parasheh Ligji për Hekurudhat e Kosovës dhe kohëzgjatjen e marrëveshjes e cila duhet të jetë për një periudhën prej 3 deri në 15 vite.

Kemi pasur takime me Hekurudhat e Malit të Zi – Montecargo, me Hekurudhat Maqedone, Kroacisë, Turqisë dhe me hekurudhat Greke.

Këtë vit ka filluar implementimi i projektit RVO, projekt i financuar nga qeveria Holandeze për trajnimin e stafit ekzekutiv, ky trajnim parashihet të jetë 4 vjeçar i ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë e 2 vjeçare ka filluar së zbatuari gjatë këtij viti ku përfshin katër module të trajnimit:

- Moduli i trajnimit të Makinistëve;
- Moduli i trajnimit të stafit të MML-së;
- Moduli i trajnimit të stafit për Operim dhe Siguri;
- Moduli për këshilla dhe përfundimi i trajnimeve.

III.2.PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH. A.

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë periudhës janar-dhjetor 2015, duke prezantuar realizimin operativ krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë dhe me realizimin e vitit paraprak. Po ashtu do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

III. 2. 1. TRANSPORTI I MALLRAVE

Sektori i transportit të mallrave është njëri prej sektorëve që ka rolin kryesor për ndërmarrjen. Rezultatet e arritura nga ky sektor në vitin 2015 janë prezantuar në vijim, ku sasia e mallrave të transportuara është shprehur në tonë:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – dhjetor 2015
Realizimi Neto Ton në 2014	837,829.54 Ton
Realizimi Neto Ton në 2015	742,439.40 Ton
Planifikimi Neto Ton në 2015	811,853.00 Ton
Dallimi: Realizim 2015 – Realizim 2014	- 95,390.14 Ton
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2015	- 69,413.60 Ton
Dallimi: Realizim 2015 – Realizim 2014 (%)	- 13.40 %
Dallimi: Realizim 2015 – Planifikim 2015 (%)	- 8.6 %

Tabela 1.1

Transporti i mallrave me kontejnerë gjatë vitit 2015 ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontonjerave	Janar – dhjetor 2015
Kontejnerë të plotë - 2015	729 copë
Kontejnerë të zbrazët - 2015	6 copë
Kontejnerë të plotë - 2014	1,018.00 copë
Kontejnerë të zbrazët - 2014	38 copë

Tabela 1.2

Siç shihet nga tabela 1.1, në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 13.4% më pak se sa në të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar si dhe rreth 8.6 % më pak se planifikimi për vitin 2015. Po ashtu, krahasuar me vitin 2014, gjatë vitit 2015 transportimi i kontejnerëve të mbushur ka qenë për 289 kontejnerë më pak dhe gjithashtu edhe transportimi i kontejnerëve të zbrazët ka qenë për 32 më pak se sa realizimi në vitin paraprak.




Figura 1.1

Siç mund të shihet nga figura 1.1, në aspektin operativ kemi një rënie të konsiderueshme nga planifikimi, e cila ka qenë për këtë periudhë raportuese duke pasur parasysh edhe numrin e kontejnerëve të transportuar gjatë vitit që po e lëmë pas.

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën vjetore 2015
Realizim shitje të hyra 2014	2,665,436.69
Realizim shitje të hyra 2015	1,872,057.96
Planifikimi 2015	2,249,527.00
Dallimi realizim 2015 - realizim 2014	- 793,378.73
Dallimi realizim – planifikim 2015	- 377,469.04
Dallimi realizim 2015 - realizim 2014 në %	- 30.00 %
Dallimi Realizim – Planifikim 2015	- 17.00 %

Tabela 1.3




Figura 1.2

Reflektimi financiar nga transporti i mallrave, siç mund të shihet nga dhënat më lart, ka ndikuar në të hyrat e vitit 2015 për **30%** më pak se sa vitin e kaluar dhe **17%** më pak se sa planifikimi për vitin 2015.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET NGA TRANSPORTI I MALLRAVE

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet gjatë 2015
Shitjet nga transporti i mallrave	1,734,612.10
Të ardhura tjera	137,445.86
Total shitjet	1,872,057.96
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	1,310,298.30
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	353,015.12
Total shpenzimet	1,663,313.42
Fitimi/humbja	208,744.54
Fitimi/humbja operative në %	13%

Tabela 1.4




Figura 1.3

Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë:

- ✓ Të ardhurat nga transportimi i kontejnerëve me vlerë: **56,712.00 €**
- ✓ Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë: **45,497.10 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga riparimi i vagonëve me vlerë: **35,236.76 €**

Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një fitim operativ prej **13 %** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përlogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për gjatë vitit 2015, duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 26.59 % nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qene për vitin 2015: 381,347.00

III. 2. 2. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate jo shumë të kënaqshme.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën janar - dhjetor 2015 me periudhën e njëjtë të vitit 2014. Në këtë tabelë shihet se kemi rënie të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtarëve për vitin e kaluar por edhe me planifikimin e vitit 2015.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i Udhëtarëve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2014	352,410
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2015	268,372
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2015	290,201
Dallimi: 2015 - 2014	- 84,038
Dallimi: realizim - planifikimi 2015	- 21,829
Dallimi: 2015 – 2014	- 23.85 %
Dallimi: realizim - planifikimi 2015	- 7.52 %

Tabela 2.1

Sic shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të vogël të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 23.85 % më pak dhe -7.52 % kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara nga pagesat.

Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Përshkrimi - Shitje e Biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2014	250,710.53 €
Realizim shitje të hyra 2015	204,668.67 €
Planifikimi 2015	241,135.00 €
Dallimi: realizim 2015 - realizim 2014	- 46,041.86 €
Dallimi: realizim - planifikim 2015	- 36,466.33 €
Dallimi: realizim 2015 - realizim 2014	- 18.36 %
Dallimi: realizim - planifikim 2015	- 15.12 %

Tabela 2.2

Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 18.36 % më pak sesa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth 7.8 % më pak sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 2.1

TË HYRAT DHE SHPENZIMET NGA TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Përshkrimi - Të hyrat	janar - dhjetor
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	789,426.50
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00
Shitjet nga transporti i udhëtarëve - bileta	195,049.32
Transport i organizuar për udhëtarë	9,619.40
Total të hyrat	1,494,095.22
Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve	1,394,184.46
Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve	974,608.50
Total shpenzimet	2,368,792.96
Fitimi / humbje operative	-874,697.74.58
Fitimi / humbje operative në %	- 39.93%

Tabela 3.3




Figura 2.2

Siç shihet nga tabela më lart, biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej - **39.93 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:

Shpenzimet indirekte janë përlogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth 73.41 % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat që ka qene për vitin 2015: 381,347.00.

III. 2. 3. SEKTORI I MIRËMBAJTJES

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën nga sektori i mirëmbajtjes së trenave motorikë, lokomotivave, lokomotivave manovruese, vagonëve për transportin e udhëtareve si dhe vagonëve për transportin e mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit janar - dhjetor 2015.

Në vijim është pasqyruar produktiviteti në shfrytëzimin e fuqisë punëtore sesa dhe ku janë shfrytëzuar këto kapacitete si dhe pasqyrohet raporti në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar.

Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **17,452.5** orë ku:

- **9,113.00** orë pune, janë shfrytëzuar për riparim apo **52.22 %** e fondit total të orëve;
- **17.49** orë pune, janë shfrytëzua për punë ndihmëse dhe dytësore apo **17.49 %** e fondit total të orëve;
- Produktiviteti i tërë ka qenë **69.71 %**.

Shërbimi i mirëmbajtjes së vagonëve gjatë periudhës janar – dhjetor ka disponuar me fuqi pune prej **13,026.00** orë ku:

- **5,792.00** orë, janë shfrytëzuar për riparim apo **44.46 %** e fondit total të orëve
1,259.00 orë, janë shfrytëzuar për punë ndihmëse dhe dytësore apo **9.67 %** e fondit total të orëve
- Produktiviteti i tërë ka qenë **54.13**

LOK. TU LOK. TM T.M. Lok. Mano.	2640 001	2640 003	2640 004	2620 005	2640 006	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2760 001	2760 002	5800 001	5800 002	5800 003	5800 004
Servisime	28	203	0	110	0	114	0	2	44	11	4	23	33	0	320
Riparime	17	23	0	18	0	14	2	2	8	11	13	10	10	0	25
K - 1	3	8	0	8	0	9	0	0	7	9	6	0	2	0	7
K - 3	1	2	0	2	0	2	0	0	2	0	0	0	0	0	2
K - 6	0	2	0	2	0	1	0	0	1	1	0	0	0	0	1

III. 3. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2015
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2015)

III. 3. 1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2015

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2015, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III. 3. 1. 1. Të hyrat

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 1,734,612.09 € për periudhën janar - dhjetor 2015. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2015, është 2,249,527.00 €. Nga kjo del se planifikimi nga kjo kategori është realizuar në shkallën prej 77.11%.

Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat e realizuara nga importi përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë në shumën prej 239,505.25 €, ndërsa nga eksporti, po ashtu përmes vijës kufitare Hani i Elezit, është realizuar shuma prej 32,852.56 €. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për “NewCo Ferronikeli” dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 1,462,524.28 €.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2015, është realizuar në shumën prej 1,494,095.17 €.

Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë realizuar 789,426.50 €, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00 €. Burimi i të ardhurave nga biletat është realizuar në shumën prej 196,917.12 €. Një e ardhur tjetër është transporti i organizuar i udhëtarëve në vlerë prej 7,751.55 €, shprehur në përqindje më realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 92,17 %, krahasuar me planifikimet e vitit 2015 – 1,613,094.00 €.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2015, kanë arritur shumën prej 102,209.10 €. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2015, e cila është 120,000.00 €, arrin kuotën e realizimit prej 85.17%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 56,712.00 € dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 45,497.10 €.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – dhjetor 2015, kanë arritur shumën prej 90,536.93 €. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë:

Të hyrat nga dëmtimi i vagonëve – 35,236.76 €, të hyrat nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh. A. – 55,300.17 €. Buxheti i planifikuar është 180,000.00 €, shprehur në përqindjen 50.29%.

Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 1,091,859.00 €, për projektet kapitale të parashikuara gjatë këtij viti është transferuar në vlerë prej 1,089,729.28 €.

Një donacion tjetër ka qenë Granti Holandez që për këtë vit është planifikuar në vlerë prej 44,210.00 €, ndërsa është realizuar në vlerë prej 29,838.70 €, pra përqindja e realizuar është 65.23 %.

Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar - dhjetor 2015, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 1,995,423,76€ nga 2,493,414.00 € të planifikuara për vitin 2015 dhe arrijnë kuotën prej 80.02%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2015.

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,773,449.30€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,1,741,006.30€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 32,443.03€. Në total nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar për vitin 2015 – 1,788,750.00€, në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 99.14%. Shpenzimet e stafit kanë pësuar një rritje për arsye se është realizuar kontrata kolektive, konkretisht stazhi i punëtoreve.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 182,270.20€, kjo shumë nëse llogariten mjetet nga Buxheti i Republikës së Kosovës për grandet është vetëm 13.54 % nga shuma totale prej 1,346,069.00 € e parashikuar vitin 2015. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e më poshtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2015.


Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 55.90%, konkretisht në shumën prej 73,342.40€. Planifikimi për vitin 2015, i kësaj kategorie është 131,200.00€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2015.

**TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN
JANAR – DHJETOR 2015**


	EMËRTIMI	Realizimi Janar- Dhjetor2015	Buxheti 2015	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor2014
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	1,734,612.09	2,249,527.00	-514,914.91	77.1100809	2,496,759.00
2	TU – Ministria e Infrastrukturës	789,426.50	871,959.00	-82,532.50	90.5348187	1,002,126.66
3	TU – Ministria e Zhvillimit Ekonomik	500,000.00	500,000.00	0.00	100	500,000.00
4	TU – Shitja e Biletave	204,668.67	241,135.05	-36,466.38	84.8771964	250,710.53
5	Shërbimet tjera	102,457.10	120,000.00	-17,542.90	85.3809167	169,194.93
6	Të ardhurat – Dëmtimi i vagonëve	35,236.76	120,000.00	-84,763.24	29.3639667	
7	Të hyrat tjera jo operative	55,300.17	60,000.00	-4,699.83	92.16695	67,849.85
I	TOTAL – TË HYRAT	3,421,701.29	4,162,621.00	-740,919.71	82.2006445	4,486,640.97
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	945,610.30	1,111,500.00	-165,889.70	85.0751507	925,340.15
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	63,299.80	52,500.00	10,799.80	120.571048	62,493.15
3	Inventar dhe pajisje	24.9	31,000.00	-30,975.10	0.08032258	181.13
4	Material harxhues	4,872.70	5,300.00	-427.30	91.9377358	17.24
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	46,459.07	122,114.00	-75,654.30	38.045655	50,501.17
6	Qasja në binarë	696,220.90	900,200.00	-203,979.10	77.340691	857,546.64
7	Sigurimi i palëve të treta	1,200.00	13,000.00	-11,800.00	9.23076923	5,570.69
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	101,574.70	171,000.00	-69,425.30	59.4004094	213,738.16
9	Shpenzimet e transportit Infracos	69,794.60	64,800.00	4,994.60	107.707716	72,827.19
10	Zbritjet e lejuara	66,366.79	22,000.00	44,366.79	301.667227	58,699.36
11	Blerje/shpenzime të tjera	0	0	0	0	537.09
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	1,995,423.76	2,493,414.00	-497,990.24	80.0277755	2,188,752.61
	Fitimi (humbja) bruto	1,426,277.53	1,669,207.00	-242,929.47	85.4464143	2,297,888.36
	TE ARDHURAT TJERA					
	Të ardhurat granti holandez	29,838.67	44,210.00	-14,371.33	67.493033	0
	Te ardhura tjera Grantet	0	1,091,859.00	-1,091,859.00	0	0
	TOTAL – Te ardhurat tjera	29,838.67	1,136,069.00	-1,106,230.79	2.62	0
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,741,006.30	1,675,750.00	65,256.30	103.894155	1,554,875.01
	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	32,443.03	113,000.00	-80,556.97	28.710646	14,746.60
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,773,449.30	1,788,750.00	-15,300.70	99.144615	1,569,621.61
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	4,210.30	1,091,859.00	-1,087,648.70	0.3856084	5,797.18
2	Sigurimi fizik – total	32,626.30	45,000.00	-12,373.70	72.5028889	34,209.78
3	Shërbimet tjera	245.3	3,000.00	-2,754.70	8.17666667	64.5
4	Shpenzimet logjistike	25,088.50	36,000.00	-10,911.50	69.6902778	28,206.38
5	Energjia elektrike dhe shërbimet komunale	433.2	1,500.00	-1,066.80	28.88	9,658.49
6	Sigurimi i palëve të treta	4,306.50	10,000.00	-5,693.50	43.065	4,049.78
7	Marketingu	2,336.60	19,500.00	-17,163.40	11.9825641	10,034.74
8	Udhëtimet zyrtare	9,272.30	35,000.00	-25,727.70	26.4922857	15,264.43
9	Telefonat dhe Posta	26,719.10	25,000.00	1,719.10	106.8764	21,709.52
10	Shërbimet bankare	1,156.80	3,000.00	-1,843.20	38.56	1,666.75
11	Tatimet	35,041.70	12,000.00	23,041.70	292.014167	5,016.85
12	Pajisje elektronike	10,994.90	20,000.00	-9,005.10	54.9745	10,853.51
13	Donacionet e dhëna	0	0	0	0	800

14	Shpenzimet e paparishukuar	29,838.70	44,210.00	-14,371.30	67.4931011	0
	TOTAL - Shpenzimet operative	182,270.20	1,346,069.00	-1,163,798.80	13.5409255	206,031.27
E	Shpenzimet administrative					
2	Inventar dhe pajisje	1,084.50	5,000.00	-3,915.50	21.69	8,477.59
3	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	12,054.30	14,500.00	-2,445.70	83.1331034	10,758.60
4	Material i zyrës	12,068.50	15,000.00	-2,931.50	80.4566667	9,329.64
5	Material sanitar	4,187.30	13,000.00	-8,812.70	32.21	9,364.35
6	Qiraja për objektet	9,206.10	10,000.00	-793.90	92.061	9,554.45
7	Reprezentacioni dhe bufeja	13,190.50	13,000.00	190.50	101.465385	12,398.78
8	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	1,015.20	15,000.00	-13,984.80	6.768	4,359.68
9	Shpenzimet logjistike	7,327.20	15,700.00	-8,372.80	46.6700637	4,196.04
10	Kontingjente	13,208.80	30,000.00	-16,791.20	44.0293333	14,548.38
	TOTAL - shpenzimet administrative	73,342.40	131,200.00	-57,857.60	55.9012195	82,987.51
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	4,024,485.60	5,759,433.00	-1,734,947.40	69,8764	4,047,393.00
III	Fitimi (Humbja) para zhvlersimit	-572,945.80	-460,743.00	112,202.80	140.13	439,247.97
	GRANTET	899,591.94	816,000.00	83,591.94	110.24	808,157.85
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	899,591.94	816,000.56	83,591.38	110.244035	808,157.85
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	72,699.84	80,000.00	-9,660.04	87.92495	157,053.50
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	972,291.78	896,000.56	73,931.34	108.25126	965,211.35
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	-645,645.64	-540,743.00	104,902.64	120.37	282,194.47
	Të ardhurat e jashtëzakonshme	745,475.00	745,475.00	0.00	100.00	0.00
	Fitimi (humbja)	99,829.36	204,732.46	-104,903.10	48,76088	282,194.47

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – dhjetor 2015



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – dhjetor 2015



III. 3. 2. Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2015)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-2015
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	474,938.06
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,989.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	276,296.95
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	260,726.40
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	447,685.40
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	40,640.33
7	BPB	300,000.00
	Totali	1,825,276.14

III. 3. 3. BILANCI I GJENDJES

BILANCI I GJENDJES		
NP HK-TRAINKOS SH. A.	GJENDJA FILLESTARE 01/01/15	GJENDJA PERFU. 31/12/15
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	6,734,782.58	5,814,440.64
Mjetet Qarkulluese	3,508,879.94	4,763,721.56
Stoqet	527,100.65	581,762.42
Paraja	1,018,322.94	1,826,035.90
Llogaritë e arkëtueshme	1,893,520.94	1,354,097.70
Kërkesa tjera të arkëtueshme		
Parapagimet	69,935.41	1,001,825.54
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	10,243,662.52	10,578,162.20
Detyrimet afatshkurta	649,635.99	507,945.95
Llogarite e pagueshme	620,079.18	475,425.35
Te pagueshme tjera - detyrime		
Detyrime tatimore	29,556.81	32,520.60
Llogarite Inter Company		
Detyrimet afatgjata	3,911,070.54	4,142,027.46
Kapitali	5,351,390.21	5,888,257.69
Fitimi/Humbja e bartur	331,565.78	
Fitim/ Humbja e vitit	0	-39,931.10
Total detyrimet dhe kapitali	10,243,662.52	10,578,162.20

III. 4. PROJEKTET KAPITALE TË HK-TRAINKOS SH. A.

Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
Furnizimi me lokomotivë dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar (mallra – udhëtarë)	Shtator	1,091,000.00	1,085,600.00	Përfunduar
Riparimi gjeneral me konvertim i dizel motorit dhe kompresorit të lokomotivës 004	Tetor	230,000.00	229,507.00	Në zbatim
Shërbimet e sigurimit fizik	Mars	45,000.00	35,000.00	Në zbatim
Auditimi i pasqyrave financiare	Janar	5,000.00	4,950.00	Në zbatim
Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva dhe vagonë	Janar	20,000.00	18,629.00	Përfunduar
Furnizimi me material higjienik	Janar	8,000.00	7,989.14	Në zbatim
Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	Janar	6,500.00	1,416.00	Në zbatim
Furnizimi me rroba mbrojtëse	Shkurt	40,000.00	25,394.90	Përfunduar
Kontrolli sistematik i punëtoreve	Mars	5,000.00	5,000.00	Në zbatim
Furnizimi dhe riparimi i ndërruesit të shpejtësive për veturë	Mars	2,200.0	2,130.00	Përfunduar
Furnizimi dhe instalimi i sistemit softuerik të hyrje - daljeve të personelit	Korrik	6,500.00	6,839.00	Përfunduar
Furnizimi dhe montimi me gjenerator	Korrik	9,000.00	8,840.00	Përfunduar
Riparimi i transmetuesve hidraulik të trenave motorik	Qershor	45,000.00	43,882.46	Përfunduar
Mirëmbajtja e sistemit financiar ALFA	Qershor	12,000.00	6,000.00	Në zbatim
Furnizimi dhe montimi i motorit të lokomotivës 009 - Caterpillar	Korrik	230,000.00	195,000.00	Në zbatim
Furnizimi me material për bufe	Qershor	7,000.00	6,839.00	Përfunduar
Riparimi i ndërruesit të shpejtësive Allison	Korrik	15,400.00	15,036.00	Përfunduar
Shërbimet e shtypjes së biletave	Qershor	6,500.00	4,854.00	Përfunduar
Shërbimet e shtypjes së reklamave dhe fllajerave	Maj	5,000.00	4,833.60	Në zbatim
Furnizimi me pajisje të IT-së	Qershor	9,000.00	8,891.00	Përfunduar
Furnizimi me derivate të naftës	Shtator 2014	1,100,000.00	1,036,636.00	Në zbatim
Furnizimi me thëngjill	Shtator	20,000.00	15,500.00	Përfunduar
Dezinfektimi i objekteve te Trainkos Sh. A.	Shtator	6,000.00	5,881.00	Përfunduar
Furnizimi me rërë për lokomotiva	Tetor	2,556.00	2,556.00	Përfunduar
Rekreacioni futboll i për stafin e kompanisë	Tetor	3,000.00	2,500.00	Përfunduar
Furnizimi me material të marketingut	Tetor	5,000.00	4,970.00	Përfunduar
Hartimi i projektit per renovim të objektit të MML-së	Tetor	9,700.00	9,285.00	Përfunduar
Furnizimi me arka fiskale	Tetor	9,000.00	8,116.00	Përfunduar
Furnizimi me pjesë të vogla ndërrimi për nevojat e HK-Trainkos Sh. A	Janar - dhjetor	30,000.00	28,857.00	Përfunduar

Furnizimi me lokomotivë dizel elektrike me riparim gjeneral për transport të kombinuar (mallra - udhëtarë) - është projekt i financuar nga Buxheti i Kosovës. Projekti është në fazën e pranimit përfundimtarë dhe të përmbylljes së tërë projektit. Për vitin 2015, projekti është realizuar në vlerën prej 752,947.00 €. Pjesa tjetër ka mbet për vitin 2016.

Riparimi gjeneral me konvertim i dizel motorit dhe kompresorit të lokomotivës 004 - është po ashtu projekt i financuar me Buxhetin e Kosovës. Projekti është në zbatim dhe për shkak të disa komplikimeve një pjesë e projektit është bartur në vitin 2016. Për vitin 2015 projekti është realizuar në vlerën prej 130,295.00 €.

Sigurimi fizik i objekteve të HK-Trainkos Sh. A. - është kontraktuar dhe është në zbatim. Kontrata është kontratë kornizë në kohëzgjatje prej një viti.

Auditimi i pasqyrave financiare - është kontraktuar dhe është në zbatim.

Furnizimi me papuçe frenuese për lokomotiva dhe vagonë - është i kontraktuar dhe i njëjti është përfunduar. Komisioni ka pranuar teknikisht projektin.

Furnizimi me material higjienik - Projekti është kontraktuar dhe është në zbatim e sipër.

Shërbimet e sigurimit të palëve të treta - Shërbimi është kontraktuar dhe kontrata është valide për një vit kalendarik.

Furnizimi me rroba mbrojtëse dhe uniforma - Projekti është kontraktuar dhe i njëjti është në zbatim e sipër. Kontrata për këtë projekt është kontratë kornizë me një operator ekonomik.

Kontrolli sistematik i punëtorëve - Projekti është kontraktuar me procedura të negociuara dhe i njëjti është kontraktuar me Institutin e Mjekësisë së Punës dhe është në zbatim e sipër.

Furnizimi dhe riparimi i ndërruesit të shpejtësisë - Projekti është kontraktuar dhe përfunduar si dhe është pranuar teknikisht.

Furnizimi dhe Instalimi i sistemit softuerik të hyrje-daljeve të personelit - Projekti është kontraktuar dhe është realizuar në tërësi nga operatori ekonomik.

Furnizimi dhe montimi i gjeneratorit - Projekti është kontraktuar dhe është realizuar.

Riparimi i transmetuesve hidraulik të trenave motorikë - Projekti është projekt i paraparë të financohet nga Buxheti i Kosovës dhe i njëjti është vlerësuar nga komisioni dhe është rekomanduar për dhënie të kontratës. Projekti është kontraktuar dhe është realizuar në tërësi.

Mirëmbajtja e sistemit financiar ALFA - Projekti për mirëmbajtjen e sistemit financiar ALFA është projekt i cili është kontraktuar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe i njëjti është në zbatim e sipër për periudhën njëvjeçare.

Furnizimi dhe montimi i motorit të lokomotivës 009 – Caterpillar - Projekti për furnizim dhe montim të motorit të lokomotivës të prodhuesit Caterpillar është projekt i cili është proceduar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë për shkak të specifikave të prodhuesit Caterpillar. Projekti është kontraktuar dhe është në zbatim e sipër.

Furnizimi me material për bufe - Projekti për furnizim me material për bufe është kontraktuar dhe është në zbatim.

Riparimi i ndërruesit të shpejtësive Allison - Projekti për riparim të ndërruesit të shpejtësive Allison është projekt i kontraktuar me buxhetin operativ të HK-Trainkos Sh. A. dhe i njëjti është realizuar në tërësi.

Shërbimet e shtypjes së biletave - Projekti për shërbimet e shtypjes së biletave për nevojat e operimeve është projekt i kontraktuar dhe përfunduar në tërësi.

Shërbimet e shtypjes së reklamave dhe flajerave - Projekti për shërbimet e shtypjes së reklamave dhe flajerave për marketingun është projekt i kontraktuar dhe në zbatim e sipër.

Furnizimi me pajisje të IT-së - është projekt i kontraktuar dhe i realizuar në tërësi.

Furnizimi me derivate te naftës - është projekt i cili është kontraktuar nga Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) si tender i centralizuar dhe ne furnizohemi nga kontrata e tyre. Projekti është në vazhdim.

Furnizimi me thëngjill - është kontraktuar me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe e njëjta është përfunduar dhe paguar. Procedura e përdorur është realizuar me Kosova Thëngjill.

Dezinfektimi i objekteve të Trainkosit - Projekti për dezinfektim të të gjitha objekteve të Trainkosit dhe të mjeteve lëvizëse është përfunduar dhe është paguar në tërësi.

Furnizimi me rërë për lokomotiva - Projekti është i kontraktuar dhe i përfunduar në tërësi.

Hartimi i projektit për renovim të objektit të MML-së - Projekti është kontraktuar dhe shërbimet janë përfunduar sipas kontratës dhe i njëjti është paguar në tërësi.

Furnizimi me pjesë të vogla ndërrimi për nevoja të HK-Trainkos Sh. A. - Projektet për furnizim me pjesë të vogla është i ndarë në projekte me vlera minimale, të cilat përfshijnë afër 40 blerje të vogla të cilat janë furnizime emergjente në rast të prishjeve apo nevojave për pjese me vlerë të vogël.

III. 5. PRERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Më poshtë janë të paraqitura objektivat tona ekonomike për vitin 2015.

- Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- Ngritja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me operatorët rajonal dhe atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor me qëllim të shkëmbimit të përvojave të suksesshme;
- Të rrisim shërbimet dhe cilësinë e tyre në transportin hekurudhor, për një zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrjes;
- Të pasurojmë parkun e mjeteve lëvizëse;
- Ngritja në Transportin e Mallrave për 10 % në krahasim me realizimin e vitit paraprak 2015;
- Ngritja në Transportin e Udhëtarëve për 5 % në krahasim me realizimin e vitit paraprak;
- Në shërbimin e mirëmbajtjes të mjeteve lëvizëse planifikohet rritje simbolike në krahasim me realizimin e vitit 2015
- Rritja e nivelit profesional-shkollime profesionale
- Krijimi i kushteve më të mira për punë
- Ngritja e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- Përmirësimi i nivelit të shërbimeve;
- Përmirësimi i komoditetit për udhëtarët;
- Përmirësimi i strukturës gjinore;
- Promovimi i shërbimeve tona në nivel gjithëpërfshirës;
- Hulumtimi i tregut dhe kuptimi më i mirë i kërkesave në treg;
- Përmirësimi i sistemit të komunikimit brenda dhe me klientë;
- Rritja e efektivitetit në dhënien e shërbimeve;
- Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike;
- Ngritja e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare

III. 6. RREZIQUET E SË ARDHMES SË KORPORATËS


Në këtë pjesë kemi paraqitur disa nga prej rreziqeve që na kanë përcjell në vazhdimësi, të cilat janë bërë kërcënim edhe për të ardhmen e kompanisë. Angazhimi ynë në këtë drejtim do të fokusohet në minimizimin e këtyre efekteve:

- Numri i vogël i mjeteve lëvizëse dhe vjetërsia e tyre;
- Mosmbulimi i shpenzimeve të Transportit të Udhëtarëve sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës;
- Buxheti i vogël për investime kapitale dhe kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat;
- Pamundësia e kontrollit të procesit të ofrimit të shërbimit për transportimin e mallrave të importuara apo të eksportuara vetëm nga ana jonë për shkak të përfshirjes të më shumë operatorëve hekurudhorë në ofrimin e këtij shërbimi;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;
- Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokimi i daljes veriore për në Serbi përmes së cilës do të lidheshim me shtetet tjera të Evropës, por edhe me porte tjera detare;
- Politika komerciale që do ta zbatojë Infrakos-i në caktimin e kushteve për shfrytëzim të rrjetit si dhe në shfrytëzimin e shërbimeve të terminalit;
- Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
- Fleksibiliteti i konkurrentëve tanë në aspektin e shpejtësisë, dërgesës, çmimit, etj;
- Kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse;
- Statusi i kompanisë që krijon disavantazh me konkurrentët tanë; dhe
- Rastet e jashtëzakonshme që ndodhin gjatë operimit të trenave.

IV. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH. A.

Skema organizative e HK-Trainkos Sh. A.

Operimi me trenë në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A vitin 2015 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2014. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2015, ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vet procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, moshën e të punësuarve, strukturën gjinore, strukturën nacionale dhe kualifikimin shkollor të të punësuarve në HK-Trainkos Sh. A. është si vijon:

Struktura e të punësuarëve në bazë të kategorizimeve të Trainkos SH.A. më 01.01.2015 dhe më 31.12.2015				
Totali i të punësuarëve	01.01.2015		31 .12.2015	
	222		231	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2015	31.12.2015	01.01.2015	31.12.2015
Mosha mesatare e punëtorëve	46.82	46.34	%	%
Me marrëdhënie të rregullt pune	222	231	%	%
Me kontratë të paafatizuar	75	69	33.78 %	29.87 %
Me kontratë të afatizuar	147	162	66.21 %	70.13 %
Meshkuj	199	206	89.63 %	89.18 %
Femra	23	25	10.36 %	10.82 %
Serb	2	2	0.90 %	0.87 %
Shqiptarë	220	229	99.09 %	99.13 %
Me shkollim fillor	17	17	7.65%	7.36%
Shkollim Të mesëm	155	137	69.81%	59.30 %
Kualifikim profesional	%	21	%	9.10%
Me shkollim të lartë	4	4	1.8%	1.73%
Me shkollim superior	46	52	20.72%	22.51%
Departamenti i Operimeve	137	142	61.71 %	61.47 %
Departamenti i Administratës	43	44	19.36 %	19.05 %
Departamenti i Fianancave	8	8	3.60%	3.46 %
Departamenti i Zhvillimit	6	6	2.70 %	2.60 %
Departamenti i Prokurimit	3	3	1.35%	1.30%
Kabineti i KE-së	7	9	3.15 %	3.90 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	15	15	6.75 %	6.49 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	3	4	1.35 %	1.73 %

Sqarim: Gjatë periudhës janar-dhjetor 2015 kemi pasur 17 punësime, 5 pensionime, 1 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës, 2 punëtorë të vdekur. Gjatë vitit 2015 kemi pasur 17 punëtorë me kontratë për punë specifike, të cilët nuk janë përfshirë në tabelën më lart. Po ashtu në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

IV.1.KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2015

Gjatë periudhës njëvjeçare Departamenti i Administratës/Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka mbajtur gjithsejtë 50 seanca gjyqësore. Kontestet Gjyqësore janë një ndër rreziqet kryesore të kompanisë, sidomos kontestet nga marrëdhënia e punës dhe kontestet për kompensim dëmi.

Këto procese janë të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës si rezultat edhe i mos përfilljes së procedurave dhe kontratave nga menaxhmenti i asaj kohe. Me qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të kompanisë, duke u bazuar në aktet normative të aplikueshme në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A, Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka ndërmarr të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme. Në propozimin e nxjerrjes së provave përmes ekspertizave dhe super ekspertizave në rastet e mungesës së disa provave me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë-kontributit të pjesëmarrësve në komunikacionin hekurudhor dhe zgjidhjes së këtyre kontesteve në favor të kompanisë Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka ndërmarr të gjitha veprimet në sigurimin e të gjitha provave elementare për ta mbrojtur kompaninë nga paditësit që kanë ngritur padi kundër Hekurudhave e Kosovës - Trainkos Sh. A për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo materiale. Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale nga zyrtarët ligjorë të Kompanisë.

Kategoritë e kontesteve për vitin 2015	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	14
Kontestet për kompensim të dëmit	24
Kontestet për pagim të borxhit	9
Penale	4
Raste e jashtzakonshem	16

Gjatë periudhës njëvjeçare kemi dy konteste të përfunduara të marrëdhënies së punës në favor të Kompanisë dhe një kontest për kompensim dëmi i cili është në procedurë të përmbaruesit.

Konteste në disfavor të kompanisë përgjatë kësaj periudhe njëvjeçare kemi një kontest për kompensim dëmi. (kontest i vitit 2010)

IV.2.KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2016

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh. A. në vitin 2016, pritet të ballafaqohemi me 63 konteste gjyqësore që nga procedura fillestare e deri te revizioni. Në tabelën më poshtë

është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2016:

Kategoritë e kontesteve për vitin 2016	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	15
Kontestet për kompensim të dëmit	32
Kontestet për pagim të borxhit	12
Penale	4

Në bazë të kësaj gjendje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi i UNMIK.

Kontestet nga marrëdhënia e punës

Gjatë vitit 2016 nga kontestet e marrëdhënies së punës në procedurë gjyqësore do të jenë 15, prej të cilave në shkallë të parë për momentin gjenden 4 konteste, kurse në shkallën e dytë gjenden 10 konteste dhe një në shkallën e tretë.

Kontestet për kompensim dëmi

Nga kontestet për kompensim të dëmit gjithsejtë në procedurë gjyqësore gjenden 32 konteste.

Gjatë vitit 2016 nga kontestet e kompensimit të dëmit në procedurë gjyqësore në shkallë të parë për momentin kemi 6 konteste ndaj të cilave vazhdon procesi gjyqësor, kurse në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë gjenden në procedurë (shkalla e dytë) 26 konteste.

Vlen për të theksuar se numri i kontesteve për kompensim dëmi po shtohet dhe kjo varësisht nga ndodhja e aksidenteve në komunikacionin hekurudhor.

Kontestet për pagim të borxhit

Nga kontestet për pagim borxhi gjatë vitit 2016 në procedurë gjyqësore kemi 12 konteste prej të cilave 11 në procedurë në shkallën e parë, kurse 1 në procedurë të përmbarimit N.T.SH.'Ballkan Shped'.

Lëndët Penale

Nga lëndët penale në procedurë aktualisht kemi 4 lëndë por ky numër do të rritet varësisht nga ftesat që do të vijnë nga gjykata.

Tani nuk mund të supozojmë për sa konteste Gjykata e Apelit të Kosovës do të vendos gjatë vitit 2016 (të gjitha kategoritë e kontesteve), dhe sa konteste do t'i kthej në rigjykim, por kemi theksuar vetëm numrin e kontesteve që gjenden në procedurë gjyqësore.

IV. 3. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR- DHJETOR 2015

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2015	373,753.33
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2015	3,493,561.01
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – dhjetor 2015	3,594,745.74
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2015	474,938.06

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2015	131,262.57
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – dhjetor 2015	1,089,728.53
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2015	944,694.15
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2015	276,296.95

V. PËRFUNDIM

Performanca pozitive e Trainkos Sh.A për vitin 2015, pik së pari është rezultat i angazhimit të palodhshëm të të gjithë strukturës organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti dhe deri tek niveli operativ.

Faktorë tjerë që kanë ndikuar në performancën e kompanisë janë gjithashtu politikat e shpenzimeve që ka ndjekur kompania duke u përqendruar vetëm në shpenzimet e nevojshme për operimin. Një faktor mjaft të rëndësishëm mund ta konsiderojmë edhe planifikimin i cili ka qenë i bazuar në parametra të matshëm dhe objektiva reale dhe të arritshme.

Që Trainkos Sh. A., të vazhdojë në të ardhmen me operim dhe biznes të suksesshëm nuk mjafton vetëm menaxhimi i mirë nga ana e strukturës organizative. Kompania tani më ka nevojë për investime serioze në flotën e mjeteve lëvizëse, përkundër faktit që në tri vitet e fundit 2013, 2014 si dhe vitin 2015, kemi operuar me fitim, buxheti i vogël i kompanisë duke përfshirë edhe pjesën e ndarë nga Aksionari për investime kapitale nuk mjaftojnë për të mbuluar investimet që kërkohen për të garantuar një qëndrueshmëri operative të kompanisë.

Është mëse e nevojshme që Aksionari bashkë me strukturat udhëheqëse të kompanisë të ndërtojë një plan të përbashkët për të realizuar këto investime që do të siguronin të ardhme të sigurt biznesore dhe funksionale të kompanisë. Duke pasur parasysh se tanimë pritet që të kemi hapje të linjave të reja të transportit veç sa e rritë nevojën për veprim në këtë aspekt.

Duke pasur parasysh se transporti hekurudhor është një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit industrial dhe ekonomik të vendit, besojmë se aksionari duhet ta vë në prioritet investimin në këtë sektor duke siguruar qëndrueshmëri për operatorin HK-Trainkos Sh. A.

Mbesim të përkushtuar maksimalisht në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e gjithmbarshëm të kompanisë dhe ofrimin e shërbimeve sa më të mira për klientët tanë, siç edhe kemi dëshmuar në dy vitet e fundit dhe siç dëshmon ky raport për vitin 2015. Ne do të zhvillojmë biznes profitabil për sa kohë nuk kemi ndikimin e faktorëve që janë jashtë mundësive tona. Jemi optimist se më shtimin e linjave të transportit vendor dhe ndërkombëtar dhe më një ofertë të mirë të transportit në të ardhmen do të kemi performancë edhe më të mirë.

Fushë Kosovë,

10.03.2016

Kryeshef Ekzekutiv
Gelor Shala

